




DPK/DMP

03-1449/13

02

21.05.2013



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN/ OSNOVNI SUD U PRIZRENU/ BASIC COURT IN PRIZREN

Nr. 468/05 /2012

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DIVIZIONI PËR KUNDERVAJTJE- me Gjyqtarin Gani Kastrati e me procesmbajtësen Mire Beqiraj , ne proceduren kundervajtëse duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga I pandehuri: Pajtim Kosova nga Prizreni rruga „ Hafiz Ismail Hakiu” , nr. 55 , paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, nr. 468/05/2012, të dt. 20.02.2013, për shkak të kundervajtjes nga neni 5,6, paragrafi 1.3, dhe neni 9, e lidhur me nenin 17 paragrafi 1.13, të Ligjit nr. 04/L-050, për deklarimin , preardhjen dhe kontrollin e pasurisë, të zyrtarëve të lartë public, dhe në bazë të neni 31 al. 2 dhe neni 195, dhe 217, të LMK-së, me dt. 13.05.2013, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET – si e BAZUAR, Ankesa e ushtruar nga ana e të pandehurit kundër aktvendimit me nr. 468/05/2012, të dt. 20.02.2013, **ashtu që kundër të paraqiturit:** Pajtim Kosova nga Prizreni rruga „ Hafiz Ismail Hakiu” , nr. 55 , e **PEZULLOJ-** proceduren kundervajtëse për shkak se nuk ka prova se ka kryer kundervajtje për të cilën është ngarkuar, në veshtrim të neni 198 al. 1 pika 1, dhe 8, e lidhur me nenin 217 al. 2, dhe 3, të LMK-së, të vërtetuar gjatë rishqyrtimit në seancën Gjyqësore dhe vlersimit të thënjeve në ankesën e paraqitur , pasi Gjykatës I ka prezentuar fakte dhe prova të reja.

SH'FYQIZOHET - aktvendimi I mëparshëm – nr. 468/05/2012, të dt. 20.02.2013, në bazë të neni 217 al. 2, të LMK-së.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të Gjykatës Themelore -divizioni për Kundervajtje në Prizren

A r s y e t i m

Me kërkesën e Agjencisë kundër korrupsionit për deklarimin e pasurisë në Prishtinë, me nr. 01-1883/2012, të dt. 24.05.2012, është ngritur procedura kundervajtëse kundër të paraqiturit: Pajtim Kosova nga Prizreni rruga „ Hafiz Ismail Hakiu” , nr. 55, për shkak të kundervajtjes si në dispozitivë të këtij aktvendimi.

Pasi Gjykata më parë në këtë qështje juridike ka vendosur me aktvendim në procedurën e rregulltë me q'rastë të paraqiturit I ka shqiptuar denim me gjobë në shumën prej 300€.

I paraqituri Pajtim Kosova me kohë dhe në afatin e rregulltë ligjor ka parashtruar ankesë kundër aktvendimit të sipër përmendur ,nr. 468/06/2012, të dt. 20.02.2013, dhe ka kërkuar ndryshimin e aktvendimit duke mos u pajtuar me denimin e shqiptuar, duke I propozuar gjykatës që denimin e atakuar ta Abrogoj, që lënda të kthehet në rivendosje, rishqyrtim dhe që I njejtë të lirohet nga përgjegjësia kundervajtëse, pasi në ankesën e ushtruar ka propozuar prova dhe fakte të reja –lista e anëtarëve të Kuvendit që I kanë dorëzuar deklaratat për vitin 2012, brenda afatit ligjor ku shifet se edhe I paraqituri Pajtim Kosova ka bërë obligimin e tij të rregulltë ligjor- dorëzimin e formularëve për deklarimin e pasurisë dhe me dt. 28.03.2012, të vërtetuar nga pika kontaktuese e zyres ligjore KK Prizren.

Gjykata pas shqyrtimit të ankesës, së paraqitur dhe vlerësimit të saj, aktvendimine goditur, ka vazhduar procedurën e rregulltë për rivendosje- rishqyrtim me q'rastë ka ndëgjuar dhe marrur në pyetje , të paraqiturin Pajtim Kosova, në seancën verbale të mbajtur me dt. 22.04.2013, I cili në deklaratën e tij në seancën e provave , I prezentoj gjykatës në shikim , origjinalin e vërtetimit –listës së anëtarëve të Kuvendit që I kanë dorëzuar formularë për deklarimin e pasurisë për vitin 2012, duke theksuar se nuk ka prova të plota mbi të cilat do të mbështet përgjegjësia e tij, I cili vërteton se me kohë dhe në mënyrë të

1807
rregulltë ka përmbushur obligimin e tij ligjor duke I dorëzuar formularet për deklarin e pasuris në zyr ligjore –pika kontaktuese në KK Prizren, dhe atë me dt. 28.03.2012, të vërtetuar edhe në bazë të formula të dorëzuar një kopje është e bashkangjitur në shkresat e lëndes si provë materjale, por sipas tij, kjo është bërë me vones të zyrtarit ligjor të Pikës kontaktuese në KK Prizren, I cili ka dorëzuar me vones Agjensionin kunder korrupsionit në Prishtinë , duke I propozuar gjykates që të aprovohet ankesa si bazuar të Abrogohet aktvendimi atakuar, dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje dhe që I nje të lirohet nga përgjegjësia dhe denimi I shqiptuar .

Gjykata pas rishqyrtimit të lëndes dhe vlerësimit të ankesës gjatë rivendosjes ka ndegjuar edhe shefin e sherbimit profesional në KK Prizren- Ibrahim Krasniqi, në seancën verbale të mbajtur me dt. 15.03.2013, I cili gjatë asaj kohe ishte si zyrtarë ligjor në pikën kontaktuese në KK Prizren, I cili ka deklaruar se I pohuar duke theksuar se I paraqituri Pajtim Kosova me kohë dhe në mënyrë të rregullt ka dorëzuar formularë për deklarin e pasuris-se I njeiti ka përmbushur obligimin e tij ligjor Brenda muajit Mars të vitit 2012, gjegjësisht me dt. 28.03.2012. Pajtim Kosova I ka sjellur formularin për deklarin e pasurisë në zyrën e tij- në pikën kontaktuese në KK Prizren, thekson shefi I sherbimit profesional Ibrahim Krasniqi, duke I prezentuar njëherit si deshmi gjykates në shikim edhe listën e anëtarëve të kuvendit që I kanë dorëzuar formularet për deklarin e pasurisë të plotësuar për vitin 2012 në të cilën listë ndër ta është edhe emri I Pajtim Kosovës , thekson Ibrahim Krasniqi në deklaratën e tij duke arsyetuar faktin se gjatë kohës ku I njeiti ka kryer këtë punë I ka njoftuar të gjithë anëtarët e kuvendit që duhet ti bëjnë deklarin e pasurisë, por thekson se nuk ka qenë në dijeni për ekzistimin e formularit për deklarin e pasuris sipas ligjit të agjensis kunder korrupsionit në Prishtinë, sepse I njeiti ng kryesuesi I Kuvendit të KK Prizrenit, është njoftuar vetëm gojarisht dhe nuk ka pasur njohuri as për formularet e as për mënyrën e procedimit por për hirë të ndihem ju ka shpërndarë anëtarëve të Kuvendit me të cilin ka poseduar sherbimi I KK Prizrenit, duke pohuar atë se me vones I ka derguar formularet për deklarin e pasuris në zyrën e AKK-së, në Prishtinë, ngase ishte arsyea e njoftimit të vonshem me formularë adekuatë thekson shefi I sherbimit profesional në KK Prizren, Ibrahim Krasniqi në deklaratën e tij, duke theksuar përfundimisht se I paraqituri Pajtim Kosova ka përmbushur obligimin e tij ligjor për deklarin e pasurisë.

Poashtu gjykata ka ndegjuar edhe parashtrusën e kërkesës – Enis Sadikun zyrtari I lartë për mbikqyrjen e pasuris dhe dhuratave në Agjensin kunder korrupsionit në KK Prishtinë, I cili pasi I njoftuar me lenden e shqyrtimit thekson se formularet e plotësuar për deklarin e pasuris I cili ka prezentuar kshilltari komunal Pajtim Kosova vlen vetëm për Komunën e Prizrenit dhe formularet nuk janë të njeiti me atë të AKK-s, edhe pse të njejit janë dorëzuar me kohë në pikën kontaktuese në KK Prizren , por formularet për deklarin e pasurisë me vones nga zyrtari ligjor I pikës kontaktuese në KK Prizren, janë dorëzuar në zyrën e AKK-së, në Prishtinë.

Andaj Gjykata pas administrimit të provave në shkresat e lëndes, vleroi thënjet në ankesën e paraqitur në afat ligjor ,nga I paraqituri i sipërshenuar, aktvendimin e atakuar , deklaratën e të pandehurit të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësorë pranë gjykates së shkalles së parë me dt. 22.04.2013, nga deshmitari i shërbimit profesional në KK Prizren, Ibrahim Krasniqi të dhënë me dt. 15.03.2013, deshmitari i parashtrusit të kërkesës, dhe provës së prezentuar –lista e anëtarëve të Kuvendit të lëshuar dhe vërtetuar nga zyrtari ligjor I Pikës kontaktuese në KK Prizren, dhe në shkresat tjera të lëndes pa dyshim është vërtetuar gjendja faktike pas rishqyrtimit të lëndes se I paraqituri Pajtim Kosova ka përmbushur obligimin e tij ligjor, Brenda afatit të rregulltë lidhur me dorëzimin e formularëve për deklarin e pasurisë, konstatohet se ankesën e paraqitur e aprovoj si të bazuar, gjë që aktvendimin e goditur e shfyqizoj , ashtu që kundër të paraqiturit Pajtim Kosova, e **PEZULLOJ** procedurën kundervajtëse në bazë të nenit 198 al. 1 dhe 8, të LMK-së, si dhe e nxjerr jashtë fuqie aktvendimin e më parshem nr. 468/05/2012, të dt. 20.02.2013, në bazë të nenit 217 al. 2 dhe 3, të LMK-së.

Me sa është cekur mbi e sipër u vendos sikur në dispozitiv të këtij aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEKRETI PËR KUNDERVAJTJE

Nr. 468/05/2012

Procesmbajtësja

Mire Beqiraj

dt. 13.05.2013

Gjyqtari

Gani Kastrati

SHËRBIMI JURIDIK, Kunder [etj] aktvendimi të dt. 20.02.2013, në bazë të nenit 8 të LMK-së, si dhe e nxjerr jashtë fuqie aktvendimin e më parshem nr. 468/05/2012, të dt. 20.02.2013, në bazë të nenit 217 al. 2 dhe 3, të LMK-së.